



Permbledhje joteknike
Vlerësim i Ndikimit në Mjedis
PROJEKTI I IMPIANTIT BETONIT
"HASTOÇI" shpk

Tetor / 2023
Tiranë, Shqipëria

Hartuar sipas kërkesave të VKM Nr, 686, datë 29.7.2015, "Për miratimin e rregullave, përgjegjësi dhe afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore"; Ligjit Nr.10 440, datë 07/07/2011, i ndryshuar, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis" SHTOJCA II. Projektet të tjera

10. Prodhime infrastrukturore.

a) Projekte për zhvillimin e pasurive të patundshme industriale;;

Përmbajtja

1. Hyrje	8
1.1. Objektivat e VNM-së (Vlerësimi i Ndikimeve Mjedisore)	8
1.2. Baza ligjore e VNM-së paraprake	10
2. Përshkrimi i Projektit	13
2.1. Informacion mbi vendndodhjen e aktivitetit	13
2.2. Përshkrimi i Projektit PROJEKTI I IMPIANTIT BETONIT	14
2.3. Sipërfaqia totale e pronës është 7060 m ²	14
2.4. Projekti i Propozuar Për Zhvillim	14
2.4.1. Përshkrim i procesit teknologjik	15
2.4.2. Procedura e funksionimit të impiantit të grumbullimit	17
3. PERSHKRIMI I GJENDJES EKZISUESSES TE MJEDISIT	18
3.1. Popullsia	18
3.1.1. Përdorimi i tokës	19
3.2. Mjedisi biologjik dhe fizik	19
3.2.1. Flora dhe Fauna	19
3.2.1.1. Flora	19
3.2.1.2. Fauna	22
3.3. Gjeologjia	26
3.3.1. Depozitimet e Kuarternarit (Q4 dl +el)	26
3.3.2. Depozitimet e Neogjemit (N12t)	26
3.3.3. Tokat	27
3.4. Zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyre	28
3.5. Reshjet	29
3.5.1. Temperatura e ajrit	30
3.5.2. Diellezimi	31
3.5.3. Era	31
3.6. Rrjeti hidrografik i zonës në studim	32
3.7. Menaxhimi i Mbetjeve Urbane	33
4. IDENTIFIKIMI DHE VLERESIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS	35
4.1. Metodologjia	35
4.2. Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në mjedis	35
4.2.1. Ndikimet në cilësinë e ajrit	35
4.2.2. Ndikimet nga zhurmat, vibrimet dhe drita	35
4.2.3. Ndikimet në tokë	36
4.2.4. Ndikimet në cilësinë e ujërave nëntokësore	37
4.2.5. Ndikimet në cilësinë e ujërave sipërfaqësore	38
4.2.6. Ndikimet në biodiversitet	38
4.2.7. Ndikimet nga trafiku dhe transporti	39
4.2.8. Ndikimet në peizazh	39
4.2.9. Rreziku i shëndetit dhe sigurisë së komunitetit dhe punëtorëve	39
4.2.10. Ndikimet në punësim dhe ekonominë lokale dhe zhvendosja ekonomike	40
5. Plani i përballimit të emergjencave	40
5.1. Sigurimi teknik	40
6. Plani i Monitorimit Mjedisor	42
7. Rekomandime	44

Figura

Figura 1. Harta e Pozicionimit të pronës në bashkinë Tiranë	13
Figura 2. Bimësia në zonën e Projektit	22
Figura 3. Bombina variegata	24
Figura 4. Bufo viridis	24
Figura 5. Podarcis muralis	25
Figura 6. Testudo hermanni	25
Figura 7. Harta gjeologjike e Tiranës	27
Figura 8. Harta pedologjike e rajonit	28
Figura 9. Harta e zonave të mbrojtura	29
Figura 10. Trendafili i erës	32

Tabla

Tabela 1. Legjislacioni për VNM-në	11
Tabela 2. Koordinatat në Gauss-Kruger të Projektit	13

SHKURTESAT

VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
EIA	(Environmental Impact Assessment),
VKM	Vendimi i Këshillit të Ministrave
IMK	Instituti i Monumenteve Kulturore
Sh.p.k	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar
km	Kilometra
Tem	Temperatura
m	Metra
AKM	Agjensia Kombëtare e Mjedisit
MKZ	Mbrojtja Kundra Zjarrit

1. Hyrje

Ky projekt studimi po kryhet me porosi të subjektit HASTOÇI" shpk përfaqësuar nga z. Mynyr Hastoçi për një investim që do të kryehet në fshatin Bërzhitë, Tiranë për projektin Impiant Betoni.

Investitori, synon të pajset me vendim për VNM duke respektuar të gjitha kërkesat e ligjit nr.10440, datë 07/07/2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis" të ndryshuar. Aktiviteti në studimi në bazë të Ligjit Nr. 10440, datë 07.07.2011 'Për vlerësimin e ndikimit në mjedis', klasifikohet në:

SHTOJCA II. Projektet të tjera

10. Prodhime infrastrukturore.

a) Projekte për zhvillimin e pasurive të patundshme industriale;

Qëllimi i VNM-së është identifikimi i ndikimeve mjedisore dhe sociale që mund të shkaktohen nga ky projekt gjatë fazës ndërtimore dhe funksionale.

1.1. Objektivat e VNM-së (Vlerësimi i Ndikimeve Mjedisore)

Çdo aktivitet njerëzor mbi mjedisin natyror shkakton ndikime të ndryshme mbi të, i cili mund të jetë i vogël ose i madh, pozitiv apo negativ, i drejtpërdrejtë apo i tërthortë. Për të vlerësuar karakterin e ndikimit, të përmasave të tij, faktorët e mjedisit mbi të cilët ushtrohen ndikimet është e nevojshme hartimi i Raportit të Vlerësimit të Ndikimeve Mjedisore (VNM). Objektivi kryesor i VNM është që vlerësimi i çdo aktiviteti njerëzor mbi mjedis të arrihet pas një studimi të thelluar i cili ka patur si qëllim kryesor menaxhimin sa më të mirë të burimeve natyrore. Ndikimet që mund të lindin gjatë shfrytëzimit të burimeve natyrore duhet të shmangen nëse është e mundur dhe nëse jo, niveli i ndikimit mbi mjedis duhet të jetë i ulët.

Termat më të rëndësishëm në Raportin e Vlerësimit të Ndikimeve në Mjedis janë:

Ndikim, është termi i cili nënkupton cdo ndryshim, negativ ose pozitiv i cili ushtrohet mbi karakteristikat e mjedisit.

Vlerësimi i ndikimit, përkufizohet si procesi i analizës të parashikimit dhe vlerësimit të ndikimit, i cili mund të lindë nga çdo lloj aktiviteti njerëzor para se ai të ushtrohet mbi mjedis.

Në referencat e ndryshme shpesh herë përshkruhen përkufizime të ndryshme se çfarë është një Raport Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis (EIA: Environmental Impact Assessment), por të gjithë kanë si objektivi mbrojtjen e mjedisit. Vlerësimi i ndikimeve dhe masat zbutëse të ndikimeve, të cilat lindin gjatë fazës ndërtimore dhe operale të një projekti mbi mjedis, janë pikat më të rëndësishme në VNM, sepse në këtë mënyrë shmangen rreziqet dhe ndikimet që mund të ushtrohen në mjedis. Gjithashtu, VNM duhet të promovojë shfrytëzimin e burimeve natyrore në mënyrë të qëndrueshme (sustainable use).

VNM-ja jep mundësinë e përcaktimit të llojeve të ndikimeve para zbatimit të projektit. Propozon masa parandaluese në raste kur evidentohen ndikimet. Për këtë arsye, VNM-ja hartohet para zbatimit të projektit dhe shqyrtimi i mirë i saj çon në marrjen e vendimeve të sakta. Gjithashtu shërben për zgjedhjen e alternativave më të mira dhe më miqësore për mjedisin.

Hartimi i një VNM-je nuk është një proces i thjeshtë, sepse cdo lloj projekti është i veçantë dhe mjedisi ku do të operohet për të marrë jetë projektet e ndryshme, është i ndryshëm. Çdo lidhje projekt-mjedis çon në një rast unik të lidhjes shkak-përfundim. Nëse në vend të VNM-së, do të shqyrtohej dhe do të analizohej vetëm kosto-përfitim, nuk do të merreshin parasysh ndikimet e mundshme në mjedis. Prandaj objektivi kryesor i VNM-së është analizimi i hollësishëm i të gjitha llojeve të ndikimeve në mjedis dhe propozimi i zgjedhjes së alternativës më të mirë që ofron projekti.

Vlerësimi mjedisor dhe social i projektit të propozuar u realizua për të vlerësuar ndikimet e mundshme negative të zbatimit të tij në vlerat natyrore të zonës ku do të zbatohet. Në thelb të vlerësimit mjedisor të projektit qëndron evidentimi i pikëprerjeve të tij me legjislacionin në fuqi, vlerave natyrore që gjenden në zonën e projektit dhe si e sa do të ndikohen në rast të zbatimit të tij. Më konkretisht, ky studim ka për qëllim:

- Të evidentojë pikëprerjet dhe bashkërendimin e projektit me kuadrin ligjor në fushën e mjedisit;
- Të përshkruajë vlerat natyrore, mjedisore dhe sociale në zonën e projektit;
- Të identifikojë ndikimet e mundshme negative në vlerat natyrore dhe në mjedis;
- Propozimi i masave për zbutjen e tyre dhe mbrojtjen e mjedisit nga këto ndikime.

Raporti i “Vlerësimeve Mjedisore dhe Sociale” përmbledh një përshkrim të projektit të propozuar, përshkrimin e karakteristikave të mjedisit ekzistues pritës, analizën e ndikimeve të mundshme në mjedis të projektit të propozuar përshkrimi i ndikimeve pozitive në zhvillimin ekonomik dhe social të zonës, planin e masave për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve të mundshme negative dhe programin e monitorimit mjedisor.

Metodat e zbatuara për përgatitjen e Raportit VNM

Përmbajtja e raportit për vlerësimin mjedisor është hartuar sipas kërkesave të legjislacionit shqiptar për raportet e vlerësimit të ndikimit në mjedis. Përmbajtja e këtij raporti iu referua kreut I (Zhvillimi i Proçedurës Paraprake të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis), të vendimit Nr.686. datë 29.07.2015.

Fazat e ndjekura në përgatitjen e VNM-së vijojnë si më poshtë:

Faza 1. Vlerësimi i kushteve aktuale të mjedisit dhe të jetës sociale-ekonomike të zonës ku do të zbatohet projekti. Në këtë fazë, grupi i ekspertëve duhet të sigurojë të gjitha informacionet e nevojshme të cilat do të përdoren gjatë evulimit të hartimit të VNM-së, për përshkrimin e gjëndjes së mjedisit dhe të zonave të ndjeshme në afërsi më zonën ku do të zbatohet projekti. Gjithashtu, në këtë fazë do të organizohen edhe ekspedita shkencore gjatë të cilave do të vëzhgohet zona e projektit e cila do të ndihmojë në përshkrimin e gjëndjes dhe vlerësimit mjedisor.

Faza 2. Në këtë fazë përcaktohen qëllimi, objektivat dhe prioritetet e implemetimit të projektit. Duke u bazuar në objektivat e projektit përcaktohen edhe objektivat mjedisore të VNM-së, të cilat më pas duhet të analizohen.

Faza 3. Studimi i informacioneve të mbledhura në fazën e parë për evulimin e vlerësimit të gjëndjes mjedisore dhe social-ekonomike. Grupi i ekspertëve social në këtë fazë analizon gjëndjen aktuale sociale të zonave përreth zonës së projektit. Analizimi i gjëndjes sociale duhet të bazohet në të dhënat e institucioneve kombëtare. Gjithashtu në këtë fazë organizohen shumë takime ndërmjet palëve të interesuara të cilat ndihmojnë në përfundimet e vlerësimit social.

Faza 4. Përcaktimi i alternativave të zbatimit të projektit. Në këtë fazë çdo alternativë e propozuar për implemetimin e projektit do të analizohet për ndikimet mjedisore që mund të shkatohen në mjedis dhe në jetën sociale. Alternativa me më pak ndikime negative në mjedis dhe në jetën social-ekonomike do të përzgjidhet si alternativa më e mirë për implemetimin e projektit. Alternativa e përzgjedhur do të klasifikohet si alternativa me më shumë ndikime pozitive në mjedisin bio-gjeo-fizik, në shëndetin e njeriut dhe në cilësinë e jetës.

Faza 5. Në këtë fazë analizohen të gjitha fazat që parashikohen për zbatimin e projektit dhe duke u bazuar në këtë analizë realizohet edhe vlerësimi mjedisor dhe ai social. Për çdo aktivitet që do të zbatohet në fazat e ndryshme të projektit përcaktohen ndikimet e mundshme që mund të shkatohen nga këto aktivitete. Ndikimet e evidentuara vlerësohen në bazë të një metode të përzgjedhur nga eksperti i mjedisit për natyrën, kohëzgjatjen dhe nivelin e tyre.

Faza 6. Identifikimi i indikatorëve mjedisorë dhe social, të cilët mund të ndikohen nga projekti. Pas realizimit të ekspeditave në zonën e projektit dhe vlerësimit të gjëndjes mjedisore të zonës, jetën social-ekonomike dhe mundësinë e zhvillimit të saj, si dhe përcaktimin e zonave me ndjeshmëri të lartë, përcaktohen edhe indikatorët përkatës mjedisorë dhe social të cilët mund të ndikohen nga zbatimi i projektit. Këta indikatorë janë prova e gjallë të cilët do të pasqyrojnë cdo ndryshim në jetën mjedisore dhe atë sociale.

1.2. Baza ligjore e VNM-së paraprake

Legjislacioni për mjedisin ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit në një nivel të lartë, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe shmangien e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

Hartimi i raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis është kërkesë e legjislacionit shqiptar dhe si i tillë ai hartohet në mbështetje të plotë me të.

Klasifikimi i raportit të VNM-së

Bazuar në ligjin nr. 10440 datë 07.07.2011 për “Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, kreu II, neni 7, “projektet private apo publike, të listuara në shtojcat I dhe II, bashkëlidhur këtij ligji, i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përputhje me kërkesat e kreu II të këtij ligji, përpara dhënies së lejes përkatëse nga autoriteti përgjegjës për zhvillimin ose jo të projektit. Klasifikimi i raportit të VNM-së bazohet në shtojcat I dhe II të veprimtarive të përcaktuara në shtojcat e ligjit të VNM-së.

Neni 8, projektet që i nënshtrohen vlerësimit paraprak të ndikimit në mjedis janë:

- projektet e listuara në shtojcën II, bashkëlidhur ligjit të VNM-së.

Neni 9, procedurës së thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis i nënshtrohen:

- projektet e listuara në shtojcën I.

Ky projekt do t'i nënshtrohet VNM-së Paraprake:

Shtojca II, 10.Prodhime Infrastrukturore

Pika a) Projekte për zhvillimin e pasurive të patundshme industriale

Ndërtimi dhe struktura e përmbajtjes së raportit paraprak të VNM-së bazohet në vendimin nr.686 datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”, kreu I.

- Lista e dokumentave për të aplikuar për procedurën e VNM-së

Dokumentacionet dhe procedurat për të ndjekur procedurën e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis mbështetur në Vendimin nr. 686 datë 29.07.2015, Kreu I; Zhvilluesi paraqet pranë Ministrisë së Mjedisit kërkesën për dokumentacionet e mëposhtme:

- Kërkesë me shkrim;
- Raport teknik të projektit;
- Raport paraprak të VNM-së;
- Akt të regjistrimit të kompanisë;
- Kopje të faturës së pagesës së tarifës së shërbimit për MM.

Tarifa e shërbimit për shqyrtimin e kërkesës nga Ministria e Mjedisit përcaktohet në udhëzimin nr.7938, datë 17.07.2014 “Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së”, ku për procesin e vlerësimit paraprak të ndikimit në mjedis tarifa është 30 000 (tridhjetë mijë) lekë.

Ligji nr. 10431 datë 10.03.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, ky ligj ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit në një nivel të lartë, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqëve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

Në bazë të këtij ligji, neni 3 i tij, citojmë objektivat e mbrojtjes së mjedisit:

- parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera të çdo lloji;
- ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit;
- ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrje publike;
- përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj;
- ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit natyror;
- mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit;

Parimet e mbështëtura në Kreun II të ligjit nr.10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”;

- parimi i zhvillimit të qëndrueshëm;
- parimi i kujdesit;
- parimi i parandalimit;
- parimi "ndotësi paguan";
- parimi i riparimit të dëmeve mjedisore, përtëritjes e riaftësimit të mjedisit të dëmtuar;
- parimi i përgjegjësisë ligjore;
- parimi i mbrojtjes në shkallë të lartë;
- parimi i integritit të mbrojtjes së mjedisit në politikat sektoriale;
- parimi i ndërgjegjësimit dhe i pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrjen mjedisore;
- parimi i transparencës në vendimmarrjen mjedisore.

Tabela 1. Legjislacioni për VNM-në

Legjislacioni bazë	
Ligji Nr.10 431 datë 9.6.2011	Për mbrojtjen e Mjedisit
Ligji Nr. 10 440 datë 07.07.2011	Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis I ndryshuar me; - Ligjin nr. 12/2015
Ligji Nr. 10 448 datë 14.07.2011	Për Lejet e Mjedis I ndryshuar me: - Ligjin nr. 60/2014 datë 19.6.2014

Ligji Nr.10 304, datë 15.7.2010 Ligji nr. 9385, datë 4.5.2005	Ligjin për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” I ndryshuar me: Ligjin nr. 36/2013 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9385, datë 4.5.2005 “për shërbimin pyjor”
Ligji Nr.10453 datë 22.09.2011 Ligji Nr.162 datë 2014 Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006 Ligji Nr.8906, datë 6.6.2002	Për menaxhimin e integruar të mbetjeve Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis Për mbrojtjen e biodiversitetit Për zonat e mbrojtura I ndryshuar me: - Ligjin Nr.9868, datë 04.02.2008
Ligji Nr.10 081, datë 23.02.2009	Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë I ndryshuar me: - Ligjin nr. 6/2015 datë 12.2.2015
Ligji Nr. 9774 datë 12.07.2007 Ligji Nr. 9672 datë 26.10.2000	Për vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës Për ratifikimin e konventës së Aarhusit” Për të drejtën e publikut për të pasur informacion dhe përfshirjen në vendimmarrje, si dhe për t’iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit
Ligji Nr. 8905 datë 6.6.2002 Ligj nr.8450, date 24.2.1999	Për mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja dhe dëmtimi Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nenprodukteve të tyre
Ligji 10 489 datë 15.12.2011	Për tregtimin dhe mbikqyrjen e tregut të produkteve joushqimore
Vendime	
Nr. 686 datë 29.07.2015	“Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”, kreu I.
Nr. 419, datë 25.06.2014	Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet
Nr. 247 datë 30.4.2014	Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore
Nr.575 datë 24.06.2015 Nr. 676, datë 20.12.2002 Nr. 177, datë 31.3.2005	Për miratimin ekërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte Për shpalljen e zonave të mbrojtura monument natyror Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjedisëve ujore pritëse
Nr.435 datë 12.09.2002	Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë
Nr. 718 datë 03.10.2011 Nr. 364 date 04.08.2011	Për mënyrën e vlerësimit të garancive financiare të lejeve minerare Për përcaktimin e kriterëve të vlerës minimale të zonës së lejuar minerare dhe të vlerës minimale të investimit e të prodhimit për një leje minerare
Nr. 1062, datë 23. 12. 2015	Për miratimin e rregullit teknik, për pajisjet dhe bashkësitë nën presion
Udhëzime dhe Rregullore	
Udhëzim Nr.7938, datë 17.07.2014	Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së
Udhëzim Nr.6527, datë 24.12.2004	Mbi vlerat e lejueshme të elementëve ndotës të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore, dhe mënyrat e kontrollit të tyre
Udhëzim Nr.8, datë 27.11.2007 Nr.302, dt.Aktit:12.04.2011	Për nivelt kufi të zhurmave në mjedisie të caktuara Për miratimin e parimeve bazë për hartimin e planit të rehabilitimit të mjedisit, të planit të veprimtarive të mbylljes së veprimtarisë

minerare, të mënyrës së përcaktimit të zonës së rrezikshme të një të drejte minerare dhe të planit të menaxhimit të mbetjeve minerare

2. Përshkrimi i Projektit

2.1. Informacion mbi vendndodhjen e aktivitetit

Vendi ku do të ngrihet betonerja është në teren të thyer me pjerësi të shpatit mbi 20-25⁰. Nodhet në pjesën perëndimore të rrugës nacionale Tiranë - Elbasan në faqen Veri-Lindore të kodrës të fshatit Bërzhitë, Tiranë.

Sipërfaqja totale e pronës është **7060 m²**

Sipërfaqja ku do ngrihet betonerja është **5022 m²**. Kjo tokë ka nevojë që fillimisht të pastrohet nga ferrat, gurrët, e pa nevojshëm dhe pastaj duhet të bëhet sistemimi sipërfaqësor i impiantit te betonit.

Nga verifikimi në vend i kësaj toke konstatohet se kjo tokë ka qënë sipërfaqe pyjore e mbuluar me shkure dhe drurë por që më vonë është shpyllëzuar për tokë buke.




Figura 1. Harta e Pozicionimit të pronës në bashkinë Tiranë

Tabela 2. Koordinatat në Gauss-Kruger të Projektit

	UTM Zone 34		Albanain Gauss		KRGJSH	
	X	Y	X_Gauss	Y_Gauss	X_Krrgjsh	Y_Krrgjsh
1	408418	4567099	4408512	4569058	492198.4	4568354
2	408395	4567084	4408489	4569043	492175.6	4568339
3	408281	4567089	4408375	4569048	492061.5	4568343
4	408253	4567095	4408347	4569054	492033.4	4568349
5	408250	4567114	4408344	4569073	492030.2	4568368
6	408291	4567137	4408385	4569096	492071	4568391
7	408319	4567143	4408413	4569102	492098.9	4568397
8	408363	4567134	4408457	4569093	492143	4568389
9	408400	4567114	4408494	4569073	492180.2	4568369

2.2. Përshkrimi i Projektit PROJEKTI I IMPIANTIT BETONIT

2.3. Sipërfaqia totale e pronës është 7060 m².

Sipërfaqia ku do ngrihet impianti është 7060 m² por vetem gjysma do te shfrytezohet per impiantin e betonit. Kjo tokë ku do të instalohet impianti i betonit ka nevojë që fillimisht të pastrohet nga ferrat, gurrët, drurët e pa nevojshëm dhe pastaj duhet të bëhet sistemimi sipërfaqësor. Mbasi kemi bërë sistemimin sipërfaqësor do të piketohen brezaret me qëllim që të mos kemi gryerje të tokës.

2.4. Projekti i Propozuar Për Zhvillim

Perzierja e çimentos ose përdorimi i çimentos në masë të madhe por jo në sheshin e ndërtimit, përfshirë ambalazhimin dhe përzierjen e çimentos, grumbullimi i betonit dhe prodhimi i blloqeve të betonit dhe produkteve të tjera të çimentos, si dhe prodhimi i llaçit, kolles, gëlqeres (parafabrikeve, paletave, etj.) Impiant per prodhim betony

- a- Kapaciteti i prodhimit te impiantit te betonit do te jete 70 m3 /ore.
- b- Kapaciteti mbajtes i sillozi 90 ton
- c- Vendepozitim inertesh 50m3
- d- Vendepozitim materiali 500 m3




Figure 1. Skema e funksionimit te impjantit

2.4.1. Përshkrim i procesit teknologjik

Procesi fillon me depozitimin e lëndës së parë, në lokacione – objekte përkatëse. Fraksionet e agregatit, sipas porosisë, depozitohen në deponë e agregatit, dhe pastaj me makineri përkatëse – lugë ngarkuese vendosen në silosin (bunkerin) e agregatit me kapacitet 150 m³, sipas fraksioneve. Çimentoja e siguruar vendoset në dy siloset gjithsej 80 ton, ndërkaq uji në rezervuarin e ujit 35000 litra. Natyrisht në sistem bëjnë pjesë edhe pompa për furnizim me ujë si dhe pajisje elektrike automatike të dozimit.

a) Agregatet e vendosura në silos sipas fraksioneve, dozohen përmes dozuesve elektropneumatik, të cilët hapen dhe mbyllen në mënyrë automatike varësisht nga komanda e dhënë, dhe njëkohësisht bëjnë matje e peshës së agregatit. Sasia e caktuar e agregatit kalon në shiritin transportues, i cili ndodhet nën siloset e agregatit, dhe i cili e transporton agregatin deri te shiriti kryesor, e që ky i fundit e përcjell lëndën deri në mikser.

b) Dozimi i çimentos bëhet përmes peshores automatike për matjen e peshës, si dhe transportohet përmes transportuesit kërmillor nga silosi. Çimentoja nga peshorja kalon në mënyrë automatike. Gjatë zbrazjes së peshojës së çimentos, aktivizohen vibruesit, të cilët sigurojnë që e gjithë sasia e çimentos të jetë larguar nga peshorja.

c) Edhe dozimi i ujit bëhet në mënyrë automatike, me dozim të programuar përmes pompës së ujit. Pas kalimit të sasisë së programuar të ujit, ventili mbyllet në mënyrë automatike.


E tërë lënda e programuar dhe e peshuar: agregati nga siloset, përmes shiritit transportues e deri në shiritin kryesor; çimentoja gjithashtu nga peshorja, përmes gypit transportues e deri në shiritin kryesor, e gjithashtu edhe uji i programuar dhe dozuar, shkarkohen në mikser (përzier).

Pajimet mund të funksionojnë në mënyrë automatike me dozim të programuar, por gjithashtu mund të funksionojnë edhe në mënyrë manuale. Menaxhimi i tërë procesit kryhet nga kabina e kontrollit, përmes pultit automatik komandues. Modulet hyrëse drejtpërdrejtë pranojnë sinjalet nga dozatorët dhe peshoret. Modulet digjitale dalëse, shërbejnë për menaxhimin e ventileve elektromagnetik, motorëve si dhe llampave sinjalizuese.

Përveç materialeve kryesore, agregatit, çimentos dhe ujit, në proces përfshihen edhe aditivët. Sidomos në sezonën e dimrit, si dhe për konstruksione të veçanta shtohen aditiv të cilët e shpejtojnë kohën e ngurtësimit. Aditivi kryesisht shtohet me ujë, ose drejtpërdrejtë në mikser. Zakonisht aditivët shtohen në masën 2-4% të masës së çimentos.

Para se të lëshohen pajimet për realizimin e procesit teknologjik për prodhimin e betonit, duhet të kryhen këto veprime;

- Duhet të sigurohet sasia e mjaftueshme e agregatit në silose.
- Duhet të sigurohet sasia e mjaftueshme e çimentos dhe duhet hapur vetëm ventilin e silosit nga i cili dëshirojmë të marrim çimento.
- Duhet të sigurohet sasia e nevojshme e ujit.
- Duhet caktuar recepturën për kualitetin e betonit të cilin dëshirojmë të e prodhojmë
- Të caktohet zgjatja e kohës së ciklit të prodhimit të betonit duke u bazuar në recepturën e caktuar




Prerje e impjantit te betonit

1. Sheshi i depozitimit te inerteve.
2. Bunkeret e inerteve.
3. Transportieret e inerteve.
4. Sillosi i cimentos.
5. Shneku i cimentos.
6. Peshorja e inerteve.
7. Peshorja e cimentos.

8. Distributori per percaktimin e sasise se ujit qe hidhet ne betoniere.
9. Perzieresi
10. Pulti i komandes dhe kontrollit te parametrave te projektuar per prodhim betoni.


2.4.2. Procedura e funksionimit të impiantit të grumbullimit:

- Ngarkohen agregatët si zhavorr dhe rërë në kazanët individualë të magazinimit dhe pasi të peshohen individualisht, ato do të dërgohen në transportuesin e rripit të ushqimit, i cili më pas i dërgon në pajisjen e peshimit në pjesën e sipërme të impiantit të betonit.
- Nën kontrollin e sistemit të kontrollit, çimentoja transportohet në peshore me anë të transportuesit me vidë; uji dhe aditivët transferohen gjithashtu në vendet e tyre përkatëse të peshimit.
- Hapen dyert pneumatike të hopave të peshimit; hapet valvula pneumatike të fluturës së peshores të çimentos, të peshimit të reres dhe p të peshimit të ujit; të aditivëve.
- Aktivizojme të gjithë vibratorët dhe pompat e presionit të hyrjes së ujit për t'i bërë të gjitha materialet të hyjnë në mikserin e betonit për t'u përzier në mënyrë të barabartë.
- Pasi të ketë mbaruar koha e fiksimit, përzierësi do ta shkarkojë përzierjen në një mikser transit ose një pompë betoni.



Dimensionet e impiantit të shprehura në mm

Teknologjia që do të përdoret, ofron mundësi të aplikimit të një procesi të mbyllur, me mundësi kontrollimi në mënyrë automatike, çka mundëson ndikime më të vogla në mjedis, si dhe efikasitet në përdorim të lëndës së parë.




Impianti i mbrojtjes kunder Zjarrit

3. PERSHKRIMI I GJENDJES EKZISUESES TE MJEDISIT

3.1. Popullsia

Në 1 Janar 2020, Tirana zë rreth 31,8 % të popullsisë gjithsej, duke vazhduar të jetë një nga qarqet më të populluara të vendit. Përlogaritjet e popullsisë në 1 Janar 2020 treguan se vetëm dy qarqe të vendit shënuan rritje të popullsisë, krahasuar me një vit më parë, ndërsa dhjetë qarqet e tjera shënuan rënie të popullsisë. Rritja më e madhe u shënuar në Tiranë (+1,2 %), pasuar nga Durrësi (+0,2 %).

Qarku/Prefekturës	2016			2017			2018			2019			2020		
	Burra	Grave	Gjithsej	Burra	Grave	Gjithsej	Burra	Grave	Gjithsej	Burra	Grave	Gjithsej	Burra	Grave	Gjithsej
Tiranë	41 9,3 51	42 3,6 30	84 2,9 81	42 7,9 15	43 4,4 46	86 2,3 61	43 6,9 17	44 7,0 79	88 3,9 96	442, 011	45 3,1 49	89 5,1 60	447, 525	45 8,6 41	90 6,1 66



3.1.1. Përdorimi i tokës

Tokat bujqësore në rajonin e zonës në studim, kanë pësuar transformime të konsiderueshme në harkun kohor të njëzet viteve të fundit, si pasojë e aktivitetit njerëzor të pakontrolluar. Dëmtimi i zinxhirit të prodhimit bujqësor në rajon ka prekur të gjithë elementët përbërës së tij duke ndërvepruar direkt mbi mjedisin në tërësi si dhe mbi jetën njerëzore.

Politikat territoriale të deritanishme nuk mundën të ruanin një zhvillim të qëndrueshëm në Sistemin e Urbanizimit Urbano-Rural si pasojë e kërkesës për zhvillim në hapsira shërbimi dhe banimi, formale dhe informale. Sistemi i vaditjes së tokave bujqësore dhe sistemi i rezervuarëve të rajonit si dhe ndërlidhja e tyre me rrjetin e burimeve ujore janë dëmtuar rëndë nga mungesa e mirëmbajtjes si dhe nga dëmtimet njerëzore. Sistemi i magazinimit përpunimit dhe ndërlidhjes së tregjeve rajonale është inekzistent si pasojë e zhvillimit të pakontrolluar dhe ndryshimit të destinacionit të përdorimit të godinave pas privatizimit të tyre në vitet 1990. Sipërfaqet e tokave bujqësore në rajon u dëmtuan rëndë nga ndërtimet formale dhe informale, duke ndryshuar efikasitetin e tyre në shfrytëzim dhe përdorim si dhe duke ndryshuar statusin e përdorimit të tokës.

3.2. Mjedi biologjik dhe fizik

3.2.1. Flora dhe Fauna

Në zonën e shfrytëzimit nuk ka ndonjë lloj ose specie flore apo faune që mbrohet me status të veçantë. Zona është e mbuluar në përgjithësi me barishte dhe shkurre mesdhetare dhe shumë pak nga bimësi e lartë.

3.2.1.1. Flora

Lista e llojeve të rrezikuara të bimëve në nivel kombëtar është shumë e madhe, gjithsej 319 lloje, nga të cilat janë të rrezikuara në formë kritike 76 lloje, konsiderohen në rrezik 123 lloje dhe të përkeqësuar 120 lloje, të cilat përballen me një rrezik të lartë në kontekstin kombëtar. Kërcenimet kryesore ndaj biodiversitetit janë: zhvillimi industrial, urbanizimi, gjuetia ilegale, peshkimi, erozioni i tokës, energjia dhe minierat, transporti dhe turizmi, sektore këto që kanë ndikim në shumëllojshmërinë biologjike. Aktivitetet antropogjene ku shpyllezimi dhe shkretëtirëzimi i tokës se punueshme, aq sa shkatërrimi i livadheve dhe kullotave, kanë pasur një ndikim të madh në ndryshimet e habitateve në të kaluarën e afërt. Ndërtimi i

rrugëve dhe ndryshimet në rrjedhën e ujit ose ndërtimi i digave, ndërtimi i tubacioneve, ndotja që vjen nga origjina të ndryshme, zjarret, sëmundjet dhe ndryshimet klimatike janë arsyet e degradimit dhe fragmentimit të habitateve në Shqipëri. Mbrojtja e biodiversitetit mund të arrihet vetëm duke pranuar dhe respektuar objektivat dhe parimet e ruajtjes dhe rritjes së zhvillimit të qëndrueshëm në sektore që lidhen me biodiversitetin, të tilla si bujqësia, pylltaria, peshkimi, industria, urbanizimi, transporti dhe turizmi.

Rajoni i Tiranës ka një mbulesë bimore tipike të zonës mesdhetare bregdetare.

Speciet mbizoteruese janë si më poshtë: *Robinia pseudoacacia*, *Populus tremula*, *Ficus sp.*, *Rubus sp.*, *Celtis australis*, *Platanus orientalis*, *Cornus mas*, *Arundo donax*, *Tamus communis*, *Smilax aspera*, *Ulmus parvifolia*, *Hedera helix*, *Juglans regia*, *Corylus avellan*, *Arundo donax*, *Populus nigra*, *Populus alba*, *Rubus sp.*, *Inula viscosa*, *Salix sp.*, *Typha latifolia*, *Populus nigra*, *Populus alba*, *Salix sp.*







Figura 2. Bimësia në zonën e Projektit

3.2.1.2. Fauna

Në koridore më pak të trazuar nga njëriu e në periferi nga ana veriore mund të takohet rrallë lepuri i egër (*Lepus europaeus*), *Plecotus auritus* (lakuriqi veshgjatë) *Nyctalus noctula* (lakuriqi i natës) ndersa brejtesit janë me evident afër ndertimeve rezidenciale e veçorisht në kanalizimet. Në avifaunën e rajonit në shqyrtim bejnë pjesë shpendë të mjedisit urban si dhe ato karakteristikë të shkurretave si *Anthus campestris*, *Corone cornix*, *Corvus corax*, *Pica pica*, *Passer domesticus*, *Carduelis carduelis*, etj. Takohen gjithashtu gargulli i zi (*Sturnix vulgaris*), lauresha (*Aleuda arvensis*), mellenja (*Turdus merula*), trishtilat, harabelat, gushkuqet etj. Veçanërisht në tërrene më të thata, reptilet janë më të pranishëm si *Lacerta viridis*, *Lacerta trilineata* (hardhucë e gjelbër me tre vija), *Podarcis muralis*, *Anguis fragilis*, *Natrix tessellata* (gjarpër) e breshka e zakonshme (*Testudo hermani*). Prania e lumit të Tiranës nëanën jug-perëndimore të zonës në studim ka favorizuar veçanërisht në dy anët e tij si dhe në kanalet kulluese praninë e amfibëve si bretkosen e zakonshme (*Rana ridibundo* Pall), thithlopën e zakonshme (*Bufo bufo*), thithlopën e gjelbërt (*Bufo viridis* Laur).

Ekosistemet bregore paraqesin një biodiversitet më interesant pasi ata paraqesin bimësi bregore natyrore dhe kështu tërheqin faunën që lidhet me ekosistemet bregore.

Tabela 1. Llojet kryesore të zonës në studim

Nr	Emri shkencor	Statusi kombetar
	Rendi odonata	
1	Sympetrum sanguineum	
	Rendi Orthoptera	
2	Gryllulus frontalis	
3	Calliptamus italicus	
4	Locusta migratoria	
	Rendi Coleoptera	
5	Scarabaeus sacer	
6	Calosoma sycophanta	VU
7	Gyrinus notator	DD
8	Anomala vitis	
9	Oxythorea funesta	
10	Cetonia aurata	
11	Lampyris noctiluca	
12	Coccinella septempunctata	
	Rendi Lepidoptera	
13	Iphiclydes podalirius	
14	Papilio machaon	
15	Aporia crataegi	
16	Pieris brassicae	
17	Colias crocea	
18	Gonepteryx Cleopatra	
19	Maniola jurtina	
20	Melanargia galathea	
21	Cynthia cardui	
	Grupi Noturna	
22	Zygaena carniolica	
23	Macroglossum stellatarum	
24	Pelosia muscerda	
	Rendi Neuroptera	
25	Libelloides ottomanus	VU
26	Mantis religiosa	LR (nt)

Herpetofauna (Amfibet dhe Reptilet)

Sic shihet llojshmëria e amfibeve është relativisht e ulët edhe për reptilë jemi në të njëjtën situatë, me pak lloje të pranishme.

Tabela 2. Llojet kryesore të amfibëve të pranishëm në zonë

Nr	Emir shkencor	Statusi Kombetar
1.	Bombina variegata	LR (nt)
2.	Bufo bufo	LR (nt)
3.	Bufo viridis	LR (nt)
4.	Rana balcanica	VU



Figura 3. Bombina variegata



Figura 4. Bufo viridis

Tabela 3. Llojet kryesore të reptilëve të pranishëm në zonë

Nr	Lloji	Statusi Kombëtar
1.	Testudo hermanni	LR (nt)
2.	Anguis fragilis	NE
3.	lacerta trilineala	LR (lc)
4.	Lacerta viridis	LR (lc)
5.	Podarcis muralis	NE
6.	Columber germonensis	LR (nt)



Figura 5. Podarcis muralis



Figura 6. Testudo hermanni

Nga krahasimi i listës së llojeve të amfibëve e reptileve në listën e kuqe të Shqipërisë rezulton një numër i madh llojesh që i perkasin kategorive të llojeve të rrezikuara ne nivel kombetar.

Ornitofauna (Shpendet)

Pjesa me e madhe e shpëndeve të hasur në këtë territori janë dimërues dhe shtegtarë, lloje që preken më pak nga shqetësimi apo ndërhyrje të tjera humane. Shpendët e përhershëm dhe ata folezues të mirëfilltë janë dhe më të rrallë. Në mënyrë jo të dretpërdrejtë ky fakt dëshmon pakësim e llojeve të cilët kanë nevojë për qetësi të plotë. Shpendët e takuar i perkasin mjedisve të tipit të shkurretave, toka bujqësore të punuara apo të braktisura dhe qendrave të banuara.

Ndër ta më të zakonshëm janë harabelorët me përfaqesues bilbithat e trishtilat. Në tokat bujqësore hasen me shpesh laureshat, bishtlekundesat, avdosat etj. Qendrat urbane strehojne shpend të përshtatur ndaj pranisë së vazhdueshme të njeriut si dallendyshet, harabelat, kukuvajkat dhe laraskat.

Mammalofauna (Gjitaret)

Nga vrojtimet në terren dhe shqyrtimi i burimeve bibliografike të mundshme mbi gjitaret e zonës është bërë e mundur të hartohet një listë e llojeve të pranishëm në zonën e studimit.

Tabela 4. Llojet kryesore të gjitarëve të pranishëm në zonën në studim.

Nr.	Lloji	Statusi Kombëtar
1.	Erinaceus concolor	
2.	Talpa caeca	
3.	Crocidura leucodon	
4.	Pipistrellus kuhli	
5.	Pipistrellus pipistrellus	
6.	Mus musculus	
7.	Mus spicilegu	
8.	Rattus norvegicus	
9.	Rattus rattus	

Nr.	Lloji	Statusi Kombëtar
10.	Vulpes vulpes	
11.	Meles meles	
12.	Mustela putorius	EN

Nga krahasimi i listes se mesiperme ne listen e kuqe te Shqiperise dhe anekset e disa konventave nderkombetare ne te cila Shqiperia eshte pale, rezulton se vetem nje lloj i perket kategorive te llojeve te rrezikuara ne nivel kombetar. Kjo njeherazi deshmon per rendesine e paket te zones ne studim ne nivel kombetar.

3.3. Gjeologjia

Ne zonen e kodrave te rruges se Elbasanit, kodrat e Farkes, te Petreles dhe te Krrabes ne Tirane jane kryer shume studime rajonale dhe lokale. Keto studime jane kryer per objekte te ndryshme qe kane te bejne me qendrueshmerine e shpateve te kesaj zone si dhe per projektimin e themeleve te objekteve shumekateshe qe jane ndertuar ne Qendren Administrative te Farkes dhe te Petreles. Kodrat bejne pjese ne zonen e Ultesires Perendimore te Shqiperise. Ne ultesiren e Tiranës jane prezente depozitimet Neogjenike dhe depozitimet e Kuarternarit, por ne zonen ku do te ndertohen objektet jane prezente depozitimet e meposhtme:

Zona në të cilën bën pjesë trualli i studiuar ndërtohet nga depozitimet gjeologjike të trajtuara si më poshtë:

- Depozitimet e Kuarternarit (Q4 dl +el)
- Depozitimet e Neogjemit (N12t)

3.3.1. Depozitimet e Kuarternarit (Q4 dl +el)

Depozitimet deluvialo-eluviale perfaqesohen nga suargjila te mesme deri te renda dhe argjila. Jane depozitime pak deri ne mesatarisht te konsoliduara, takohen ne gjithe zonen ku do te ndertohet objekti ne pjesen siperfaqesore dhe ka trashesi 3.20-4.20m. Keto depozitime siç e kemi permendur me siper jane te paqendrueshme, ato rreshqasin ne drejtim te renies se relivit, prandaj nuk rekomandohet qe ne keto depozitime te vendosen themelet e objekteve te ndryshme.

3.3.2. Depozitimet e Neogjemit (N12t)

Nga studimi i kryer ne kete shesh ndertimi jane identifikuar dhe depozitimet e Neogjenit qe perbehen nga argjilite, ranore dhe alevrolite me ngjyre gri me çimentim te dobet deri mesatar, pjesa e siperme e ketyre depozitimeve eshte e perajruar. Keto depozitime formojne shpate te paqendrueshme dhe me pjerrsi te bute. Në pergjithesi janë të mbuluar nga mbulesë deluvialo-eluviale por ato dalin në sipërfaqe në pjese të veçanta në kodrat e Berzhitës, të Petrelës dhe të Farkës në rrethin e Tiranës.




Figura 7. Harta gjeologjike e Tiranës

3.3.3. Tokat

Zona në studim përfaqësohet nga tokat e hinjta. Tokat e Hinjta Kafe janë të përqëndruara në malet e ulëta dhe kodrat e zonës bregdetare ndërmjet lartësive 0 dhe 200 m mbi nivelin e detit (në disa zona shtrihen deri 600 m lartësi). Duke filluar nga bregu i detit, ato shtrihen në brendësi të territorit, në thellësi 80 – 100 km. Formimi i tokave të Hinjta kafe është kushtëzuar nga klima Mesdhetare kodrinore dhe fushore. Sipas treguesve hidrotermikë, në këtë brez tokësor dallohen dy zona klimatike: zona Mesdhetare fushore dhe zona mesdhetare kodrinore.

Materiali primar. Tokat e Hinjta Kafe formohen në materiale primare me nature të ndryshme, si proluviale, diluviale, aluviale dhe liqenore. Këto të fundit paraqiten me teksturë, përbërje mineralogjike dhe kimike të ndryshme. Depozitimet proluviale ndeshen mjaft rrallë dhe vetëm në fundin e shpateve shumë të pjerrëta të kodrave. Ato janë të paseleksionuara. Depozitimet deluviale vendosen në pjesën fundore të shpateve të pjerrëta të kodrave. Kanë ngjyrë të hirtë në të verdhë, përberje mekanike subranore e subargjilore, si dhe përmbajnë karbonate. Pjesa e trashë e tyre përbëhet kryesisht nga kuarci, ndërsa pjesa e imët nga hidromikat dhe mineralet e dyta të grupit të montmorilonitit. Pjesa e imët e depozitimeve subargjilore me ngjyrë të kuqe përbëhet nga hidromikat, caoliniti dhe oksidet e hidratuara të Fe.




Figura 8. Harta pedologjike e rajonit

3.4. Zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyre

Zona në fjalë nuk bën pjesë në asnjë kategori të zonave të mbrojtura dhe nuk mbart vlera kulturore dhe historike.




Figura 9. Harta e zonave të mbrojtura¹

3.5. Reshjet

Për shkak të veprimtarisë së gjërë ciklonare sasia më e madhe e reshjeve vihen re në gjysmën e ftohtë të vitit, dhe ajo më e ulet në periudhën e ngrohtë të tij. Zona në studim është një nga zonat që karakterizohet nga sasi reshjesh vjetore të ulta mesatarisht 931 mm ne vit të cilat bien kryesisht në formë shiu.

Muaji me më shumë reshje është muaji nëntor (132.9 mm), i ndjekur nga muaji dhjetor (113 mm). Muaji me më pak reshje është muaji korrik me 23.9 mm. Numri i ditëve me reshje ≥ 1.0 mm varion nga 2.4 ditë (korrik) deri në 11.1 ditë (dhjetor). Gjatë vitit ka mesatarisht 86.4 ditë me reshje ≥ 1.0 mm.

Zona në studim nuk klasifikohet si zonë me sasi të mëdha reshjesh 24-orëshe, ose më mirë ajo bën pjesë në zonat ku shirat janë më pak të rrëmbyeshëm. Megjithatë nuk përjashtohen edhe rastet kur sasia maksimale 24-oreshe ka arritur 180.8mm dhe 182.5mm përkatësisht në muajt nëntor dhe tetor. Ndërsa maksimumi 24 h për periudhën 30 vjeçare varion nga 43.0 mm në korrik (për vlerën me te ulet) deri në 182.5 mm ne tetor te vitit 1962.

Rreshjet janë një element i rëndësishëm meteorologjik, që në rajonin e Tiranës kryesisht përfaqësohen nga shiu. Në tabelën më poshtë paraqitet sasia e reshjeve sipas muajve dhe numri i ditëve me reshje gjatë vitit bazuar në të dhënat shumë vjeçare meteorologjike.

¹ (Burimi:Raporti i Gjendjes se Mjedisit 2014)

Tabela 5. Sasia e reshjeve mujore dhe numri i ditëve me reshje gjatë vitit bazuar në të dhënat shumë vjecare meteorologjike

Muajt Reshjet	01	02	03	04	05	06	07	08	09	10	11	12	Vjetor	
Reshjet mujore mm	112	98	86	60	57	28	12	20	35	131	164	150	983	
Max 24 orësh mm	89	83.6	63	66.1	67	77	35	65.3	72.3	182.5	180.8	59	1042.6	
Numri i diteve me reshje	0.1 mm	13.3	11.5	10.7	8.8	7.5	4.9	3.5	3.5	5.7	10.7	12.4	14.4	106.9
	5 mm	6.1	5.5	5.1	3.5	3.3	1.8	1.0	1.5	2.5	5.4	8.5	7.2	51.4
	10 mm	4.2	3.3	2.7	1.9	1.9	0.9	0.5	0.9	1.6	3.6	5.5	4.1	31.1

3.5.1. Temperatura e ajrit

Në rajonin e Tiranës, temperatura është më e lartë në muajt e verës (Korrik - Gusht), ku edhe sasia e energjisë diellore është më e madhe, ndërsa temperatura më e ulët është në dimër, në muajin Shkurt. Përsa i përket veçorive sezonale mund të themi se gjysma e ngrohtë Prill-Shtator karakterizohet nga një temperaturë mesatare prej 20,6°C ndërsa gjysma e ftohtë është 12,4°C. Performanca vjetore e temperaturave absolute maksimale të ajrit është e njëjtë me atë të temperaturave mesatare, dmth me një minimum në janar dhe një maksimum në korrik ose gusht. Temperaturat maksimale absolute > 30 ° C fillojnë të regjistrohen nga maji dhe vazhdojnë deri në shtator. Temperatura maksimale më e lartë absolute e vërejtur është 38.6°C në korrik (viti 1988). Një nga treguesit më të rëndësishëm për të karakterizuar temperaturat maksimale të ajrit është mesatarja maksimale, vlerat e së cilës variojnë nga 12 ° C në janar deri në 27.8 ° C në korrik. Në këtë zonë janë vërejtur vlera jo shumë të ulëta të temperaturës minimale absolute. Shfaqja e vlerave negative të këtij treguesi nuk është një ngjarje e rrallë. Këto vlera sigurisht që janë të pranishme në gjysmën e ftohtë të vitit. Minimumi i tyre absolut arrihet në janar (-6.0 ° C). Por duhet përmendur gjithashtu se vlera të ulëta të këtij treguesi janë vërejtur që nga nëntori (-1.6 ° C) deri në mars (-5.2 ° C). Kjo zonë, si në rastin e rrezatimit diellor, karakterizohet nga një numër i madh orësh me diell. Mesatarisht gjatë vitit ka 2655 orë me diell, me vlerën më të lartë në korrik me 355 orë dhe më të ultën në dhjetor me 107 orë.

Tabela 6. Temperatura gjatë gjithë vitit në Durrës dhe Tiranë

Mujore	01	02	03	04	05	06	07	08	09	10	11	12	
Temperatura													
Mesatare oC	7.9	8.8	11.0	14.4	18.1	21.9	24.0	23.9	21.4	17.6	13.7	10.0	
Mesatarja mujore	Me e larta	-11.6	11.7	14.2	16.6	20.7	23.8	26.2	25.8	24.0	20.2	15.8	12.1
	Me e ulta	4.1	5.4	7.8	11.9	16.7	19.4	22.7	21.0	19.6	15.2	11.9	6.4
Max.absolute	18.8	22.1	24.9	28.6	31.3	35.0	37.7	39.0	34.0	32.2	26.0	21.7	
Min.absolute	-7.4	-4.6	-3.0	2.4	6.2	11.0	13.6	11.0	8.2	5.0	2.0	-7.2	

3.5.2. Diellezimi

Rajoni diellëzim të lartë. Vlera e rrezatimit vjetor varjojnë nga 2600 në 2700 orë. Numri i ditëve me diell varion nga 320-330 ditë.

Rrezatimi diellor ndjek pothuajse të njëjtën shpërndarje vjetore ndër vite. Energjia mesatare diellore gjatë një viti është 1600 kW orë, vlerat më të larta janë vërejtur në korrik 223.5 kW orë dhe më e ulta në dhjetor 52.9 kW/orë. Në tabelën vijuese jepen shpërndarjet mesatare mujore shumëvjeçare të diellëzimit dhe rrezatimit diellor.

Tabela 7. Diellëzimi (orë) dhe rrezatimi diellor (kW h/m²)

Stacioni i monitorimit	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Vjetore
Tirana	6.5	5.8	5.2	4.6	5.5	8.1	17.3	17.6	13.5	9.6	6.1	6.1	105.9

Tabela 8. Vlera mesatare e diteve me re

Stacioni i monitorimit	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Vjetore
Tirana	12.3	12.6	12.2	11.7	7.2	4.3	1.2	1.8	3.6	7.2	11.9	12.7	98.7

Tabela 9. Vlera mesatare e rrezatimit

Stacioni i monitorimit	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Vjetore
Tirana	142.9	208.3	300	358.1	476.8	549.1	570	511	398.7	270	172.5	135.6	4093

3.5.3. Era

Të dhënat për shpejtësinë e erës për rajonin janë:

- 30 m/sek: një herë në çdo 10 vjet
- 33 m/sek: një herë në çdo 20 vjet
- 38 m/sek: një herë në çdo 50 vjet.

Tabela 10. Intesiteti i erës sipas drejtimeve

Nr	Elemente	No era	Drejtimi								
			V	VL	L	JL	J	JP	P	VP	
1.	Shpërndarja vjetore e drejtimit në %	11.9	27.5	2.9	4.3	16.7	8.2	4.7	12.5	8.1	
2.	Shpejtësia mesatare, m/s	-	3.3	2.4	3.5	4.5	6.7	5.8	4.9	4.4	




Figura 10. Trendafili i erës

Siç mund të shihet, periudhat pa erë përfaqësojnë 11.9% të rasteve totale të drejtimit të erës. Duke iu referuar tabelës dhe trëndafilit të erës vërejmë se drejtimi verior është mbizotërues me 27.5%, ndërsa vlerat minimale të rasteve janë sipas drejtimit verilindor me 2.9%. Shpejtësitë mesatare sipas këtyre drejtimeve janë: 3.3 dhe 2.4 m / s përkatësisht.

Tabela 11. Mesatarja e shpejtësisë së erës sipas stinëve

Nr.	Stinët	Shpejtësia m/s
1	Dimri (XII-I)	4.9
2	Pranvera (III-V)	4.4
3	Vera (VI-VIII)	3.9
4	Vjeshta (IX-XII)	4.3
5	Vjetore (I-XII)	4.4

Referuar tabelës së mësipërme, shpejtësia mesatare në sezonin e dimrit është 4.9 m / s, ndërsa mesatarja vjetore është 4.4 m / s. Erërat e forta që fryjnë në veri, juglindje me shpejtësi 40-45 m / s zakonisht kanë një kohëzgjatje të kufizuar. Erërat me shpejtësi 10-20 m / s jo vetëm që kanë një shans më të madh por edhe kanë drejtim më të qëndrueshëm.

3.6. Rrjeti hidrografik i zonës në studim

Nga studimet e kryera në zonën e kodrave të Petrelës, Farkës dhe Selitës (nga matjet e kryera në shpimet për disa vite në punimet e ndryshme që autorët kanë kryer për këtë zonë) rezulton se niveli i ujit nëntokësor në dimër dhe në verë është shumë i ndryshëm. Autorët e këtij studimi kanë shfrytëzuar të gjitha punimet ekzistuese dhe punimet e reja në to janë kryer matje në disa kohë gjatë gjithë periudhës së studimit dhe rezulton se në pjesën më të madhe të zonës niveli i ujit nëntokësor është larg sipërfaqes së tokës (-5.50m),

ky nivel është nivel minimal i ujit nëntokësor, por ka raste kur niveli i ujit është dhe afer sipërfaqës së tokës kjo ndodh në momentin e reshjeve masive dhe në kontaktin ndërmjet shtresave argjiliteve dhe ranoreve dalin burime me prurje te vogel dhe sezonale.

Nga analizat e kryera rezulton se janë ujra neutrale, ato nuk janë agresive karshi hekurit dhe betonit.




Figura 2. Harta hidrologjike rajonit ne studim

3.7. Menaxhimi i Mbetjeve Urbane

Menaxhimi i mbetjeve të ngurta urbane përbën një nga problemet më të mprehta në Shqipëri. Politikat në fushën e mbetjeve synojnë përmirësimin e administrimit të mbetjeve, me qëllim që të pakësohen rreziqet që i kanosen shëndetit njerëzor dhe mjedisor, duke synuar përmbushjen e kërkesave të KE.

Progres më i dukshëm në fushën e administrimit të mbetjeve të ngurta urbane është bërë në drejtim të legjislacionit. Gjatë viteve 2005 – 2012 legjislacioni për menaxhimin e mbetjeve është përmirësuar me ligje te reja, vendime dhe rregullore/udhëzues që reflektojnë direktivat/vendimet e KE dhe kërkesat e Konventës se Bazelit.

Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Mbetjeve përcakton drejtimin e politikës së Qeverisë Shqiptare për menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve deri në vitin 2025 e ndarë në 3 faza operationale me nga 5 vjet secila. Objektivat e kësaj draft strategjie janë:

- Deri në vitin 2015 synon riciklimin/ kompostimin e 25% të mbetjeve bashkiake;
- Deri në vitin 2020 synon të ndalojë rritjen e mbetjeve bashkiake të prodhuara; Riciklimin/kompostimin 55% të mbetjeve bashkiake;

- Deri në 2025: Rikuperimin e energjisë nga 15 % e mbetjeve bashkiake. Reduktimin e mbetjeve bashkiake në lëndfill nga 90% që është aktualisht, në rreth 30%;

Niveli i menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri është i ulët. Shërbimi i grumbullimit të mbetjeve të ngurta urbane ofrohet në shumë qytete, por jo në zonat rurale. Mbetjet depozitohen në vendgrumbullimet e përacktura nga bashkitë. Depozitimi i tyre bëhet shesht e depozitimit, të cilat nuk plotësojnë parametrat e duhura për depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve. Ky menaxhim i dobët i mbetjeve përmes hedhjes së tyre së bashku pa ndonjë ndarje dhe trajtim në vend-depozitim shkakton emëtime të ndotësve në ajër dhe ujë. Në komunitet më të vogla nuk sigurohet shërbimi i mbledhjes së mbetjeve dhe individët janë përgjegjës për largimin e mbetjeve të tyre. Kjo shpesh rezulton në hedhjen pa kriter të mbetjeve përgjatë rrugëve, lumenjve dhe djegien e tyre në mjedis të hapur.

Rikuperimi, ri-përdorimi dhe riciklimi i mbetjeve është mjaft i kufizuar. Sistemi i grumbullimit të mbetjeve për biznesin riciklues është organizuar në mënyrë informale.

Deri tani, megjithëse është pranuar me ligj, mbetjet e rrezikshme hidhen në të njëjtat vende me mbetjet jo të rrezikshme. Paketimi dhe etiketimi i tyre nuk vihet në praktike, megjithëse legjislativi e parashikon këtë.

4. IDENTIFIKIMI DHE VLERESIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS

4.1. Metodologjia

Vlerësimi i ndikimit në mjedis i një projektit të propozuar është vlerësimi i ndikimeve të rëndësishme, të mundshme, të asaj veprimtarie në mjedis. Gjatë vlerësimit të ndikimit në mjedis kryhet identifikimi, përshkrimi dhe vlerësimi në mënyrën e duhur i ndikimit në mjedis të veprimtarisë, duke përcaktuar efektet e mundshme të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta mbi tokën, ujin, detin, ajrin, pyjet, klimën, shëndetin e njeriut, florën dhe faunën, peizazhin natyror, pasuritë materiale, trashëgiminë kulturore, duke pasur parasysh edhe lidhjet e tyre të ndërsjellta. Vlerësimi i ndikimit në mjedis zbaton parimin e parandalimit që në fazën e hershme të planifikimit të projektit, me qëllim shmangien apo minimizimin e efekteve negative në mjedis, përmes harmonizimit dhe përshtatjes së saj me kapacitetin bartës të mjedisit. Ky raport hartohet mbi bazën e mbrojtjes së mjedisit dhe në funksion të institucioneve vendim-marrese për licensimin ose jo të aktiviteteve të ndryshme.

Impiantet e betonit janë një burim kryesor i ndotjes së ajrit për shkak të emetimit të grimcave, oksideve të azotit dhe përbërjeve organike të avullueshme. Këto impiante gjithashtu konsumojnë sasi të mëdha uji dhe gjenerojnë mbeturina që mund të kontribuojnë në ndotjen e ujit.

4.2. Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në mjedis

4.2.1. Ndikimet në cilësinë e ajrit

Ndikimet potenciale në cilësinë e ajrit priten gjatë fazës së ndërtimit dhe sidomos gjatë fazës së operimit, megjithëse këto ndikime vlerësohen të përkohshme dhe të lokalizuara në zonat e punës. Dy burimet kryesore të emetimeve në ajër të cilat mund të kenë ndikime negative në cilësinë e ajrit gjatë fazës së ndërtimit janë emëtimet e pluhurit nga punimet e tokës dhe emetimet e gazeve nga automjetet/ makineritë dhe pajisjet e punës.

Punime civile që gjenerojnë pluhur mund të përfshijnë lëvizjen e makinerive dhe gërmimin e dherave si dhe gjatë levizjes së automjeteve në rrugët/ segmentet e pashtruara, gjithashtu edhe ngritja e pluhurit në pezull për shkak të veprimit të erës në sipërfaqet e ekspozuara. Emëtimet potenciale të shkarkimeve mund të përfshijnë pajisjet motorike të lidhura me pastrimin e bimësisë, procesin e gërmimit (makineritë) dhe gjeneratorët me djegie të naftës gjatë punimeve tokësore. Makineritë/ mjetet tipike të përdorura në këto lloj punimesh përfshijnë: eskavatorë, kamionë transportues, etj si dhe pajisjet e përfshira në transportimin e materialeve, dhe furnizuesve. Ndotësit e gjeneruar nga këto burime të emetimit përfshijnë lëndët e ngurta pezull (PM), monoksidit të karbonit (CO), oksideve të azotit (NOx) dhe dioksidit të squfurit (SO₂). Emëtimet e pluhurit priten të ndodhin vetëm gjatë fazës së ndërtimit dhe mund të rezultojnë nga secili prej proçeseve të lartpërmendura.

Gjatë fazës së operimit të projektit Impiant betoni do të kemi emetime të ndotësve të ajrit nga:

- Gjeneratorë me naftë (NOX, CO₂ PM, etj.)
- Transporti rrugor (NOX, CO₂, PM, etj.);
- Emetimet nga impianti i betonit (SO_x, CO₂, etj.)

4.2.2. Ndikimet nga zhurmat, vibrimet dhe drita

Gjatë fazave të projektit do të gjenerohet zhurmë, vibrime dhe dritë, e cila si pasojë mund të ndikojë negativisht në komunitetet lokale dhe faunën e zonës. Ndikimet mund të ndodhin kryesisht pranë zona se projektit pranë zonës së kampit të punëtorëve dhe përgjatë rrugëve hyrëse.

Gjatë **fazës së ndërtimit** do të ketë ndikime nga zhurma, vibrime dhe emetim drite si pasojë e :

- aktiviteteve të ndërtimit dhe makinerive të rënda
- zhurma që vjen nga rritja e trafikut
- përdorimi i dritave që do të përdoren për të lehtësuar dhe garantuar kushte të sigurt pune, si dhe për arsye sigurie.

Gjatë fazës **së operimit te impiantit te betonit** do të ketë ndikime nga zhurma, vibrime dhe emetim drite nga:

- nga aktivitetet e impiantit te betonit (gjeneratorë, pajisje, tubat e çelikut, makineri të rënda);
- zhurma që rezulton nga trafiku i shtuar
- zhurma, vibrimet (gjeneratorët, procesi i trajtimit dhe dritat që përdoren për të ndricuar sheshin e impiantit);
- zhurma dhe drita nga flakëruesi
- zhurma dhe vibrimet nga kamionët e përdorur në Studimin e Profilizimit Vertikal Sizmik;

Gjatë **fazës së braktisjes, çmobilizimit** do të ketë ndikime nga zhurma, vibrime dhe emetim drite nga:

- aktivitetit të braktisjes së impiantit te betonit
- rritja e trafikut

Aty ku ndërtimi do të kryhet pranë receptorëve sensitivë dhe aktivitetet që gjenerojnë zhurma janë të pashmangshme, këto do të kenë një kohëzgjatje të kufizuar në çdo vendndodhje dhe do të kufizohen në ato orë të ditës që të minimizojnë shqetësimet.

Pajisjet që lëshojnë zhurmë duhet të jenë në përputhje me standardet e zbatueshme të zhurmës së BE-së për këto pajisje siç përshkruhet në Direktivën e BE-së nr. 2000/14/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 8 majit 2000, për përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare, në lidhje me emetimin e zhurmës në mjedis nga pajisjet për përdorim të jashtëm. Të gjitha pajisjet që lëshojnë zhurmë do të mirëmbahen siç duhet për të minimizuar ndikimin e zhurmës në zonë, ndërkohë që në zonat e ndjeshme, mund të aplikohen masa mbrojtëse ndaj zhurmave.

4.2.3. Ndikimet në tokë

Zhvillimi i projektit ndikon në tjetërsimin e sipërfaqes së tokës dhe substancat kontaminuese që lidhen me produktet e betonit mund të rrjedhin dhe të ndotin tokën. Ndikimet, nëse ndodhin, mund të jenë të vazhdueshme, por në përgjithësi janë në afërsi të aktivitetit të impiantit te betonit. Ndotja mund të jetë e ndryshueshme në varësi të metodave dhe materialeve të përdorura. Nivelet e agjentëve kontaminues mund të mos përfaqësojnë kërcënime të menjëhershme mjedisore, por mund të ketë efekte kumulative afatgjata të ndryshimit të tokës dhe toksikanëve mbi organizmat.

Ndikimet në tokë gjatë **fazës së ndërtimit** janë:

- Heqja e tokës së sipërme dhe bimësisë; heqja e gurëve;
- Ngjeshja e tokës për shkak të transportit rrugor;
- Degradimi dhe erozioni nga dheu i grumbulluar;
- Derdhjet aksidentale nga automjetet dhe pajisjet;

- Ndotja aksidentale nga mbeturinave si filtrat e vajit të ujërave të zeza sanitare, lecka vajore, tubat fluoeshente, kanaçe aerosol, PPM të kontaminuara, etj.;

Ndikimet në tokë gjatë fazës së operimit janë:

- Degradimi dhe erozioni nga toka e grumbulluar;
- Ngjeshja e tokës për shkak të transportit rrugor;
- Ndotja nga derdhjet aksidentale nga automjetet, pajisjet, objektet e magazinimit, gjeneratorët, tubat dhe procese të tjera (rrjedhje të karburanteve, lubrifikantëve dhe substancave të tjera të rrezikshme);
- Ndotja nga derdhjet aksidentale të kimikateve stimuluuese;
- Ndotja nga derdhjet aksidentale të mbetjeve;
- Ndotja nga ujërat e kontaminuar të rrjedhjes (ujërat e stuhisë);
- Ngjeshja e tokës për shkak të funksionimit të kamionëve;

Ndikim në tokë gjatë fazës së braktisjes, çmobilizimit të impiantit te betonit janë:

- Ngjeshja e tokës për shkak të transportit rrugor;
- Ndotja nga derdhjet aksidentale nga automjetet, pajisjet, objektet e magazinimit, gjeneratorët, gypat dhe proceset e tjera (rrjedhje të karburanteve, lubrifikantëve dhe substancave të tjera të rrezikshme);
- Ndotja aksidentale nga mbeturinave si filtrat e vajit të ujërave të zeza sanitare, lecka vajore, tubat fluoeshente, kanaçe aerosol, PPM të kontaminuara, etj.;

4.2.4. Ndikimet në cilësinë e ujërave nëntokësorë

Zona ku ndodhet projekti përëhet nga formacione flishore të Miocenit te siperm të cilat janë shumë të varfër në ujëra nëntokësore dhe praktikisht konsiderohen si jo-akuifer. Ujërat nëntokësore lokale janë të lidhura me shtresa të pakta ranore të cilat ofrojnë sasi shumë të ulëta uji, që dalin në sipërfaqen e tokës si burime të regjimit sezonal. Edhe pse zona është e varfër me ujëra nëntokësorë pritet që gjatë fazave të ndryshme të projektit të ketë ndikime në cilësinë e ujërave nëntokësorë.

Gjatë **fazës së ndërtimit**, ndikimet në cilësinë e ujërave nëntokësore mund të rezultojnë nga infiltrimi i derdhjeve aksidentale nga automjetet, makineritë e rënda dhe pajisjet ose rrjedhjet nga sistemi i grumbullimit të ujërave të zeza për objektet sanitare të disponueshme në kantierin e punës, si dhe ndotje e mundshme që rezulton nga asgjësimi i materialit të gërmuar. Ndikime të tilla mund të rezultojnë në futjen e lëndëve organike, hidrokarbureve (vajrave), koliformeve ose metaleve të rënda në shtresat e pakta ranore me përmbajtje të ujërave nëntokësore të cekët. Ndotja organike ose hidrokarbure mund të rrisë ngarkesën biokimike të kërkesës për oksigjen (BOD) në ujërat nëntokësore.

Gjatë **fazës së operimit**, ndikimet në cilësinë e ujërave nëntokësore mund të rezultojnë nga:

- Infiltrimi i derdhjeve aksidentale nga automjetet, makineritë e rënda, pajisjet, objektet e magazinimit, gjeneratorët, tubacionet dhe proceset e tjera (rrjedhjet e karburanteve, lubrifikantit, etj);
- Infiltrimi i derdhjeve aksidentale të kimikateve;

Gjatë **fazës së braktisjes, çmobilizimit**, ndikimet në cilësinë e ujërave nëntokësore mund të rezultojnë nga:

- Infiltrimi i derdhjeve aksidentale nga automjetet, pajisjet, objektet e magazinimit, gjeneratorët, gypat dhe proceset e tjera (rrjedhje të karburanteve, lubrifikantëve dhe substancave të tjera të rrezikshme);

4.2.5. Ndikimet në cilësinë e ujërave sipërfaqësore

Pranë zonës së projektit ndodhen Lumi Erzen I cili përfaqëson një trup të rëndësishëm ujq sipërfaqësor të zonës së studimit.

Ndikimet e mundshme në ujërat sipërfaqësore mund të lidhen potencialisht me:

- Shtyllat e sedimentit dhe ndryshimi në sasinë e rrjedhjes: Sipërfaqet dhe rrugët e asfaltuara dhe të tjera të projektit gjithashtu kullojnë më shpejt se në kushtet aktuale. Kjo çon në rrjedhje më të shpejtë dhe rritje të rrezikut të erozionit dhe përmytjeve.
- Kontaminimi: Uji sipërfaqësor mund të kontaminohet kur rrjedhjet sipërfaqësore rrjedhin mbi një sipërfaqe të kontaminuar (p.sh., për shkak të një derdhjeje aksidentale).
- Konsumi i ujit: Konsumi i burimeve ujore sipërfaqësore mund të rezultojë në konkurrencë me përdoruesit e tjerë të ujit (nëse çdo kërkesë për ujë përputhet). Aktualisht, rezervuarët në zonë nuk shfrytëzohen për nevoja bujqësore ose nevoja të tjera.

Gjatë **fazës së braktisjes, çmobilizimit**, ndikimet në cilësinë e ujërave sipërfaqësore mund të rezultojnë nga:

Lëvizja e dheut dhe punimet e gërmimit; rrjedhja e reshjeve/ujrat e stuhisë nga vendi dhe rrugët; derdhjet aksidentale nga automjetet, pajisjet, objektet e magazinimit, gjeneratorët, gypat dhe proceset e tjera (rrjedhje të karburanteve, lubrifikantëve dhe substancave të tjera të rrezikshme);

4.2.6. Ndikimet në biodiversitet

Në zonën e projektit dhe në afërsi të saj nuk ndodhet asnjë zonë e mbrojtur, zonë e rëndësishme për zogjtë apo zonë emeralde.

Brenda zonës së projektit gjendet një gamë e varfer habitatesh si: zona bujqësore të punueshme dhe të braktisura, , prania e trupave ujorë të ëmbël si p.sh.përrenj etj

Gjatë **fazës së ndërtimit** të projektit do vihet re copëzimi ose dëmtimi i habitatit ekologjik i cili është në proporcion me sipërfaqen totale të zonës së pastruar përpara ndërtimit të impiantit. Bimësia dhe shtresa e sipërme e tokës do të hiqen për zhvillimin e impiantit të betonit, rrugëve hyrëse, tubacioneve dhe objekteve të tjera ndihmëse . Aktivitetet e ndërtimit do të rezultojnë në humbje të mundshme të specieve të florës (bari, shkurre) dhe habitateve në zonën e projektit, të cilat duke marrë parasysh vlerat ekzistuese të biodiversitetit të zonës nuk do të rezultojnë në ndikime të rëndësishme. Aktivitetet e ndërtimit do të sjellin shqetësim të habitatit natyror që përdoret kryesisht nga zvarranikët, amfibët dhe shpendët . Gjithashtu këto aktivitete rrisin mundësinë e aksidentave të mundshme të zvarranikëve dhe amfibëve si pasojë e gërmimeve dhe qarkullimit të makinerive si dhe mundësinë e përhapjes së specieve aliene.

Gjatë **fazës së operimit**, ekologjia tokësore dhe biodiversiteti mund të preken në rast të ngjarjeve aksidentale. Ndikimet e mundshme mund të rezultojnë nga ngjarjet e mëposhtme aksidentale (jo rutinë):

- Derdhjet dhe rrjedhjet;
- Ndezja emergjente;
- Zjarri; dhe,
- Shpërthimi.

Ngjarjet aksidentale mund të paraqesin rreziqe për ndikime në speciet e faunës dhe florës në afërsi të zonës së propozuar të projektit. Rrjedhjet e hidrokarbureve potencialisht mund të ndodhin nga automjetet që përdorin karburant dizel që mirëmbahen keq; rrjedhje të tilla janë të rrezikshme dhe mund të ndikojnë në integritetin e ekologjisë tokësore dhe habitateve.

Gjithashtu, menaxhimi jo i duhur i mbetjeve të ngurta nga fuqia punëtore mund të rezultojë në ndikime në speciet e biodiversitetit. Një problem tjetër janë ndezjet emergjente që mund të ndikojnë në fluturimin e shpendëve në zonë. Ndoshta do t'i largonte zogjtë nga zona përkohësisht me disa lëndime të mundshme.

Zjarri dhe shpërthimi mund të dëmtojnë speciet e faunës dhe florës. Pas ndërtimit të impiantit të betonit do të vendoset një plan i duhur i menaxhimit të zjarrit dhe shpërthimit. Planit do të miratohet nga autoritetet kompetente dhe do të jenë në përputhje me standardet e Shell. Planet e duhura të menaxhimit të emergjencave (përfshirë mbrojtjen nga zjarri dhe shpërthimi) do të vendosen dhe efikasiteti i këtyre planeve do të testohet përmes stërvitjeve periodike.

4.2.7. Ndikimet nga trafiku dhe transporti

Gjatë fazave të ndryshme të projektit pritet të ketë një rritje të trafikut dhe bllokimeve lidhur me ndërtimin dhe/ose mbylljet dhe devijimet e pjesshme të rrugëve, veçanërisht gjatë transportit të ngarkesave speciale (zhavorr, makineri të rënda, pajisje shpimi, etj.). Kjo ndikon përdoruesit e rrugës duke përfshirë shoferët, këmbësorët dhe përdoruesit e transportit publik.

Rreziku për rritjen e numrit të aksidenteve në afërsi të kantierëve aktive të ndërtimit nga trafiku i lidhur me ndërtimin dhe/ose mbylljet dhe devijimet e pjesshme të rrugëve.

Përkeqësimi i cilësisë së transportit dhe rrugëve hyrëse (gropa, baltë, etj.) nga automjetet e rënda dhe ndikimet e mëvonshme të përdoruesit e rrjetit rrugor.

Ndryshime në biodiversitetin, cilësinë e ajrit, zhurmën dhe dridhjet, dhe ndikime në receptorët përkatës.

4.2.8. Ndikimet në peizazh

Zhvillimi i projektit do të sjellë një sërë elementesh të reja në peizazhin ekzistues dhe mjediset vizuale.

Ndikimet në peizazh gjatë fazave të ndryshme të projektit pershkruhen si më poshtë:

Faza e ndërtimit: mobilizimi, vendosja e pajisjeve, materialeve dhe makinerive në kantier në zonën e propozuar të projektit, punimet e tokës dhe lëvizja e automjeteve. Këto aktivitete do të krijojnë një efekt të përkohshëm në cilësinë vizuale në vendin ku do të ndërtohet projekti dhe përreth tij.;

Faza e operimit: grumbullimet e dheut, prania e pajisjeve të rënda që do të përdoren për aktivitetet e shpimit, flakëruesi kur është aktiv etj.

Faza e braktisjes, e çmobilizimit. heqja e pajisjeve dhe makinerive të rënda, ndryshimi i topografisë së kantierit për shkak të aktiviteteve të projektit.

4.2.9. Rreziku i shëndetit dhe sigurisë së komunitetit dhe punëtorëve

Zhvillimi i aktivitetit të linjes të prodhimit të betonit nuk ka ndikime në shëndetin e popullsisë së zonës. Ky aktivitet nuk përdor lëndë të rrezikshme për shëndetin e punonjësve si dhe të popullsisë përreth zonës dhe si rrjedhim nuk ndikon negativisht tek ata. Në projekt nuk janë parashikuar ndryshime në popullsinë e zonës, të zhvendosjes së saj, për shkak të këtij projekti. Në sheshin e zbatimit të projektit nuk ka patur qender të banuar. Gjatë fazës së funksionimit të linjes së impiantit të prodhimit të betonit nuk ka ndikime negative në shëndetin fizik dhe mendor të popullsisë, por ka efekte pozitive në punësimin direkt të popullsisë së zonës duke rritur kështu edhe nivelin e jetesës së tyre.

Zhvillimi i projektit do të përfshijë një sërë aktivitete që mund të jenë të pasigurta për punëtorët dhe komunitetin lokal, në rast se nuk merren masa lehtësuese. Disa nga ndikimet paraqiten më poshtë:

- Rritje e rreziqeve të shëndetit në punë për shkak të ndotjes nga pluhuri dhe zhurma;
- Rritja e përhapjes së sëmundjeve që vijnë nga fluksi i punëtorëve të ndërtimit
- Rreziku i aksesit të komunitetit në vendet e përkohshme të punës gjatë punimeve;
- Rritja e rrezikut të lëndimit – fataliteti i punëtorëve të ndërtimit nga ndërmarrja e aktiviteteve të ndërtimit, rritje e rrezikut të sigurisë për shkak të përdorimit të gabuar të makinerive të ndërtimit etj;.

4.2.10. Ndikimet në punësim dhe ekonominë lokale dhe zhvendosja ekonomike

Punësimi është një çështje relativisht e ndjeshme në zonën e projektit për shkak të mungesës së mundësive ekzistuese të punësimit

Projekti do të zhvillojë mundësi të reja punësimi gjatë të gjitha fazave, megjithëse ato mund të jenë të kufizuara dhe afatshkurtëra. Pozicionet me aftësi të ulëta për banorët lokalë pa dyshim do të jenë të disponueshme, edhe pse ato do të jenë të kufizuara. Punësimi i individëve nga komunitetet lokale do të jetë i dobishëm pasi pritet të çojë në përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet Projektit dhe komuniteteve lokale.

. Prania e punëtorëve në zonën e projektit dhe paratë që ata fitojnë dhe shpenzojnë, në një afat të shkurtër do të rrisë fitimin për bizneset vendase, si kafeteri/restorante të vogla dhe shërbime të tjera të ngjashme. Prania e punëtorëve në zonën e projektit mund të përmirësojë ekonominë lokale përmes blerjes së mallrave në vend. Duke pasur parasysh që punëtorët do të shpenzojnë para për shërbimet lokale, kjo do të ndikojë në mikroekonominë e banorëve.

Nga ana tjetër me zhvillimin e projektit pritet të ketë ndikim dhe në zhvendosjen ekonomike. Kjo lidhet me:

- Humbjen e të ardhurave bujqësore për pronarët e tokave;
- Humbjen e të ardhurave bujqësore nga qiraja e tokës (marrëveshjet formale të qirasë);
- Humbjen e aksesit në pronën publike dhe private;
- Ndikimet në rendimentet bujqësore nga rritja e niveleve të pluhurit;
- Humbjen e shërbimeve të ekosistemit – gjuetia;

5. Plani i përballimit të emergjencave

5.1. Sigurimi teknik

Mbrojta e shëndetit dhe siguria në punë janë në qendër të vëmendjes së shoqërisë. Për të mbajtur një regjim të fortë të sigurisë në punë dhe shëndetit të plotë të punonjësve do të merren masat e mëposhtme:

Do të punësohen punonjës që e kanë mbushur moshën për punë dhe specialistë të profesioneve që kërkohen.

Do të punësohen punonjës që kanë eksperiencë të gjatë në profesion. Punonjësit para fillimit të punës dhe gjatë saj në mënyrë periodike do të instruktohen për rreziqet në punë dhe masat e mënyrat për parandalimin e tyre. Masat për mbrojtjen nga zjarri do të jenë pjesë e instruksioneve të tabelave lajmëruese e parandaluese. Programi i menaxhimit të ndikimit në mjedis që ka aktiviteti i pikës së karburantit. Për të shmangur dhe menaxhuar sa më mirë ndikimet negative në mjedis të shkaktuara nga elementët e

përshkruar më sipër, investitori nëpërmjet personelit të tij ka përpiluar dhe do të zbatojë një plan efikas menaxhimi të ndikimit në mjedis.

6. Plani i Monitorimit Mjedisor

Çështjet mjedisore/ sociale	Parametrat që do të monitorohen	Ku do të monitorohet?	Si do të monitorohet? Lloji mjeteve që do përdoret	Kur do të monitorohet? (Shpeshtësia)	Pse do të monitorohet?	Kush do të monitorojë?
Ndikimet në ujë	Parametrat e ujit, Ujërat e ndotur	Rrjedha e poshtme e shkarkimeve të ujërave të ndotur; Shkarkimet e ujërave të ndotur në ujëra sipërfaqësor; Ujëra nëntokësor, për shembull, në vende shkarkimi/punime civile.	Inspektim vizual, Kampionim dhe analizë laboratorike	Gjatë funksionimit	Për të verifikuar pajtueshmërinë me normat e lejuara të VKM-së No. 177 të 31 Marsit, 2005 ose kufizime të tjera përkatëse.	Kontraktori Nëse kërkohet ARM/Inspektoriati Mjedisor, Autoritetet Lokale
Ndotja e dheut/ tokës	Naftë dhe Graso Metalet totale Parametra shtesë në varësi të llojit të ndotjes	Derdhje substancash të rrezikshme, magazinimi i mbetjeve dhe lëndëve	Inspektim vizual, nëse kërkohet kampionim dhe analizë laboratorike;	Gjatë funksionimit	Për të zbuluar dhe zbutur çdo ndotje të tokës	Kontraktori Nëse kërkohet ARM/Inspektoriati Mjedisor, Autoritetet Lokale
Cilësia e ajrit	Parametrat e ajrit	Burimet e zjarrit/ tymi (për incidente) Ndotje me pluhur dhe ajër gjatë ngarkimit dhe transportimit	Mjete për kontrollin e cilësisë ajrit (Tuba)	Gjatë funksionimit	Për të siguruar cilësinë e ajrit, kryesisht afër zonave të banuara. Pajtueshmëri me standardet e cilësisë së ajrit dhe adresim i ankesave te publikut;	Kontraktori Nëse kërkohet ARM/Inspektoriati Mjedisor, Autoritetet Lokale
Zhurma	Niveli i zhurmës në mjedis (Leq, Max SPL, Min SPL)	300 metra nga aktivitetet e projektit	Instrument i zhurmës	Inspektime rutinë bazuar mbi inspektimin e ankesave (mjetet përkatëse)	Verifikim i pajtueshmërisë me kufijtë e lejuar; Për të siguruar cilësinë mjedisore, shëndetin dhe sigurinë.	Kontraktori Nëse kërkohet ARM/Inspektoriati Mjedisor, Autoritetet Lokale
Krijimi i mbetjeve	Rrezikshmëria/ toksiciteti	Zona e ruajtjes së mbetjeve, magazina, zonat e tjera	Inspektimi Vizual Fatura Raporte	Inspektimet rutinë	Për të siguruar cilësi mjedisore, shëndet dhe siguri.	Kontraktori Nëse kërkohet ARM/Inspektoriati

			Analiza te mbetjeve nëse kërkohet		Pajtueshmëri me standardet e menaxhimit të mbetjeve	Mjedisor, Autoritetet Lokale
Shëndeti dhe Siguria në punë	Përdorimi i pajisjeve mbrojtëse; Shenjat e Informimit vizual; Procedurat SHSM	Në zonë dhe mjediset përreth (nëse kërkohet)	Inspektimi Vizual Kërkesat e Planit të Menaxhimit SHSM Raporte	Inspektimet rutinë	Për të siguruar cilësi mjedisore, shëndet dhe siguri. Pajtueshmëri me standardet e menaxhimit të mbetjeve	Kontraktori Nëse kërkohet ARM/Inspektoriati Mjedisor, Autoritetet Lokale
Infrastruktura dhe shërbimet	Mbulimi dhe kontrollimi i ngarkesave për të mos shkaktuar shpërndarje/ derdhje/ shkarkime gjatë transportit për arsye sigurie.	Përgjatë rrugëve lokale	Inspektimi vizual Kërkesat e planit të menaxhimit SHSM Raportet	Inspektimet vizuale (foto)	Shmangja aksidenteve potenciale dhe shkarkimi i materialeve/substancave	Kontraktori Nëse kërkohet ARM/Inspektoriati Mjedisor, Autoritetet Lokale

7. Rekomandime

Me qëllim ruajtjen e kësaj shkallë ndikimi rekomandojmë që zhvilluesi të zbatojë rekomandimet e mëposhtëme:

- Të zbatojë me përpikmeri të gjitha kushtet e vendosura në këtë raport VNM-je;
- Të jetë bashkëpunues me komunitetin për çdo shqetësim që ata mund të kenë nga zhvillimi i kësaj veprimtarie;
- Zhvilluesi të jetë bashkëpunues me institucionet për mbrojtjen e mjedisit;
- Të kryhet menaxhim i integruar i mbetjeve të ngurta duke i seleksionuar dhe menaxhuar nëpërmjet marrëveshjeve kontraktuale me Njësinë e Qeverisjes Vendore ose subjekte të licensuara për këtë qëllim;
- Të mos hidhet asnjë mbetje e ngurtë ose e lëngët në mjedisin ujor dhe atë tokësor të zonës;
- Të kryhet monitorimi i treguesve mjedisorë dhe raporti periodik i vetëmonitorimit, dhe të dorëzohet në AKM çdo tre muaj për periudhën e punimeve të ndërtimit;
- Mirëmbajta dhe gjelbërimi në mënyrë të vazhdueshme i mjediseve përreth serrave duke ruajtur nje imazh të këndshëm;
- Të rehabilitohet mjedisi i zonës, duke mbjellë bimë të larta në perimetrin e serrave për të reduktuar impaktin vizual.

